



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



01- Nr - 070/04- 1997e dt. 15.06. 2020

Në vështrim të nenit 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 15 paragrafi 2 të Ligjit Nr.04/L-179 për Transportin Rrugor, nenin 17 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, Konkursit Nr. 13-111-15240, të datës 08.05.2020, nenit 49 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kryetari i Komunës, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit për shqyrtimin e dokumentacionit për dhënien e lejeve për linjat e autobusëve të kompanive transportuese urbano - periferike

- I. Anëtarët e komisionit për shqyrtimin e dokumentacionit për dhënien e lejeve për linjat e autobusëve të kompanive transportuese urbano – periferike në Komunën e Drenasit janë:
 1. Antigona Durmishi, (kryetar),
 2. Ibrahim Hajdari, (anëtarë),
 3. Ardian Gashi, (anëtarë),
 4. Xhevat Heta, (anëtarë),
 5. Bujar Plakiqi, (anëtarë).
- II. Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e dokumentacionit sipas kriterëve të kërkuara në baze të konkursit Nr.13-111-15240, të datës 08.05.2020.
- III. Çdo zyrtar gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdeklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat ose të personave të afërm me të lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit dhe të tërhiqet nga kjo vendimmarrje.
- IV. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Komunës.



Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci

Iu dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- DSHPE-së;
- Anëtarëve të Komisionit;
- Arkivit të Komunës së Drenasit.